
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 25.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Qira operationale për 5 automjete për A.ZH.B.R

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Automjete 34100000-8

Marrje me qira e veturave të pasagjerëve me shofer 60171000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,100,000.00 (dymbëdhjetë milion e njëqind mijë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 8, pika 1 të DST.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori ekonomik**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga **data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të lotit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës

dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme, dhe në përputhje me objektin e prokurimit), si më poshtë:

SH EN ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente / të barazvlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, si sistem i lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit.

Standarti ISO 9001:2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" - është i nevojshëm pasi garanton AK, se operatori ka një sistem të menaxhimit të cilësisë të vendosur dhe funksional, duke siguruar cilësinë në çdo proces të zbatimit të kontratës, si dorëzimin e mjeteve, menaxhimin e proceseve të mirëmbajtjes, pajisjes me dokumentacion dhe ripërtërijen e tij.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë** se merr përsipër pajisjen e mjetit/eve me siguracionin e nevojshëm, për të gjithë periudhën e qirasë së plotë operationale, sipas specifikimeve teknike.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë** se do të mbulojë të gjitha detyrimet në lidhje me institucionet përkatëse (taksa rrugore / qarkullimi të vitit përkatës / etj), sipas specifikimeve teknike.

Argumentim për kriteret 3 dhe 4: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 3 dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se Operatori ekonomik është pronari i automjeteve që vendos në dispozicion, të gjitha detyrimet që lidhen me automjetin janë pagesë e tij, është thelbësore për garantimin e një shërbimi të sigurt, ligjor dhe pa kosto shtesë. Këto kushte vendosin përgjegjësi të qarta mbi operatorin ekonomik dhe garantojnë një shërbim të pandërprerë, profesional dhe të sigurt për nevojat kryerjes së transportit të AK Përfitues.

5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **skeden teknike / broshuren / katalogun teknik** / fragmente te tyre, me qëllim krahasimin e specifikimeve të mjeteve të ofruara në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 6, germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter siguron verifikimin e përputhshmërisë së mjeteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, duke garantuar aftësinë teknike të ofertuesit për furnizimin e AK me mjete sipas kushteve të përcaktuara.

6. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sipas specifikimeve teknike.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

- Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në specifikimet teknike ku përfshihen kryerja e riparimeve rutinë. Ky kriter është në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë teknike të mjeteve, si dhe mosndërprerjes së shërbimit të AK përfitues.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për mjetet e kërkuara dhe lëvrimin të shërbimit janë përcjellë pranë OBP të hartuara nga grupi i punës i përcaktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R)” për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT